

**VENDIM**  
**Nr. 575, datë 24.6.2015**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte me qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe mbrojtjen e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative.

2. Miratimi i kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte synon të disiplinojë procesin e grumbullimit, transportit, dorëzimit dhe trajtimit të mbetjeve inerte në fushën e ndërtimit, duke përcaktuar rregullat dhe kërkesat konkrete për subjektet që operojnë në këtë fushë.

3. Në këtë vendim përcaktohen:

- a) detyrimet e zotëruesit të mbetjeve inerte dhe operatorit;
- b) kërkesat për miratimin, ndërtimin dhe funksionimin e lëndfilleve për mbetjet inerte e të venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte;
- c) kërkesat për subjektet, të cilat kryejnë punime në fushën e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo të prishjes së objekteve që prodhojnë mbetje.

4. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Termi “Zotërues i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar.

5. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t'i ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

6. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

7. Zotëruesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lëndfilleve të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

8. Njësitë e qeverisjes vendore, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit,

riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të zbatimit të projektit, të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi, personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, paraqet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kopje të dokumentacionit që provojnë përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi.

10. Subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

11. Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga NJQV-ja, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të këtij vendimi, në lëndfillin ose në venddepozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, NJQV-ja konfiskon garancinë financiare.

12. Subjekti fizik/juridik, që prodhon mbetje inerte gjatë ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes së objektit, është përgjegjës për dëmet e drejtpërdrejta ndaj palëve të treta që dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe nga detyrimet kontraktuale.

13. Njësitë e qeverisjes vendore, në planet e përgjithshme vendore, të hartuara sipas nenit 20, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas nenit 13, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, duhet të parashikojnë vende për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe lëndfilllet për mbetjet inerte.

14. Në vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte, të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3 500 tonë në vit mbetje inerte. Afati i dorëzimit të mbetjeve inerte në venddepozitimin e përkohshëm të jetë deri në momentin e ndërtimit të lëndfillit për trajtimin e mbetjeve inerte në zonën më të afërt gjeografikisht të njësisë së qeverisjes vendore.

15. Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lëndfilllet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

16. Tarifa e përcaktuar për trajtimin e mbetjeve inerte në lëndfille duhet të mbulojë koston e operimit për trajtimin e këtyre mbetjeve, si dhe koston për mbylljen e kujdesin pas mbylljes së lëndfillit për një periudhë prej të paktën 30 (tridhjetë) vjetësh.

17. Ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

- a) Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- b) Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
- c) Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- ç) Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me shkronjën “a”.

18. Ndërtimi i lëndfillit të mbetjeve inerte kryhet nga subjekte të licencuara, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lëndfilllet e mbetjeve”, dhe përkatësisht:

- a) kërkesat e përgjithshme për të gjitha kategoritë e lëndfilleve;
- b) procedurat dhe kriteret e pranimin të mbetjeve;
- c) vlerësimin e sigurisë për pranimin e mbetjeve në venddepozitimet nëntokësore;
- ç) përmbledhjen e opsioneve të asgjësimit në lëndfill;
- d) procedurën e kontrollit dhe vetëmonitorimit në fazat e operimit dhe kujdesit pas mbylljes.

19. Lendfillet e mbetjeve inerte mund të jenë lendfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose lendfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit ku do të ndërtohet lendfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij.

20. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në lendfille dhe venddepozitimet e përkohshme, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë. NJQV-të duhet, që, brenda muajit janar të çdo viti, të dërgojnë te ministria që mbulon infrastrukturën publike të dhënat vjetore për mbetjet e trajtuara në lendfille dhe venddepozitime të përkohshme të mbetjeve inerte.

21. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën publike, brenda afatit 2-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të përcaktojnë vendet përkatëse për venddepozitimet e përkohshme dhe lendfillet për trajtimin e mbetjeve inerte, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lendfillet e mbetjeve”.

22. Shkeljet e kërkesave të këtij vendimi, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me sanksione të përcaktuara në pikën 35, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

23. Ngarkohen inspektorati kombëtar përgjegjës për mjedisin, inspektorati kombëtar përgjegjës për ndërtimet, si dhe inspektoratet vendore përgjegjëse për ndërtimet që të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme mbi zotëruesit e mbetjeve inerte, venddepozitimet e përkohshme dhe lendfillet për trajtimin e tyre.

24. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja nr. 1, datë 30.3.2007, e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit, nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre”, shfuqizohet.

25. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, inspektorati kombëtar përgjegjës për ndërtimet dhe organet e njëjësive të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**